



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 13/10 Prot.

Tiranë, më 17.05.2022

V E N D I M

Nr. 34, datë 17.05.2022

Për emërimin e z.Remzi Duraku oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjiyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Komisioni i Policisë Gjiyqësore, i mbledhur në datën 17.05.2022, pasi mori në shqyrtim Propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.130/155 prot., datë 09.05.2022 “Propozim për emërim të oficerëve të policisë gjyqësore”, administroi gjithë praktikën e mbajtur për procedurën e ndjekur nga Prokuroria e Përgjithshme për organizimin dhe kryerjen e fazës së konkurimit të zhvilluar për përzgjedhjen e kandidatëve për oficerë të policisë gjyqësore dhe diskutoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

Prokurori i Përgjithshëm, ka përcjellë në Komisionin e Policisë Gjiyqësore kërkesën nr. 130/155 prot., datë 09.05.2022, nëpërmjet së cilës propozon emërimin e 21 oficerëve të policisë gjyqësore, në seksionet e Policisë Gjiyqësore të Prokurorisë, mbështetur në nenin 18, pika 2 e ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjiyqësore”.

Në propozimin e Prokurorisë së Përgjithshme, parashtrohet procedura e ndjekur nga Prokurori i Përgjithshëm për përzgjedhjen e emrave që propozohen për tu emëruar si oficer të Policisë Gjiyqësore, për të plotësuar vendet vakant për oficerë të policisë gjyqësore, të shpallura nga ky institucion me njoftimin nr.130, prot, datë 01.02.2022 “Për shpallje të vendeve vakantë për oficerë të Policisë Gjiyqësore” në disa prokurori të rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm. Propozimi përmban emrat e kandidatëve të cilët kanë rezultuar fitues në konkurimin e organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe propozohen për tu emëruar oficerë të Policisë Gjiyqësore.

Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm shoqërohet me dokumentacionin e mbajtur për gjithë fazat e procesit administrativ që ky institucion ka zhvilluar për zhvillimin e konkurimit dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues.

Në listën e të propozuarve, Prokurori i Përgjithshëm ka përfshirë kandidatin fitues, Remzi Duraku, duke propozuar emërimin e tij, oficer i Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Nga përmbajtja e propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe akteve që e shoqërojnë, rezulton se:

Prokurori i Përgjithshëm, në ushtrim të kompetencave që i jep ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë“, neni 38, pika 2, gërmat “dh” dhe “e” dhe ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nenet 17 dhe 18, me njoftimin nr. 130 prot., datë 01.02.2022, ka bërë shpalljen e vendeve të lira për 21 oficerë të policisë gjyqësore në seksionet e policisë gjyqësore të disa prokurorive të shkallës së parë, të juridiksionit të përgjithshëm. Në njoftim specifikohen prokuroritë ku ekzistojnë vendet e lira dhe numri i tyre për çdo prokurori. Njoftimi është shpallur në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme dhe është afishuar në ambientet e dukshme të godinës së këtij institucioni, duke ftuar të interesuarit të aplikojnë për këto vende.

Me urdhërin nr.12, datë 02.03.2022, “Për caktimin e Komisionit të Vlerësimit të Aftësive”, Prokurori i Përgjithshëm ka ngarkuar Komisionin e Vlerësimit të përbërë nga dy prokurorë dhe një oficer i Policisë Gjyqësore, për kryerjen e procedurës së konkurimit të kandidatëve, sipas fazave dhe rregullave të parashikuara në Rregulloren nr.21/6, datë 10.06.2020 “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të Prokurorisë”.

Sikurse rezulton nga aktet bashkëlidhur propozimit, konkurimi është zhvilluar sipas procedurës së parashikuar në rregulloren e sipërcituar.

Rezulton se pas skualifikimit të kandidatëve nga verifikimi paraprak, për mosplotësim kriteresh, janë kualifikuar dhe kanë marrë pjesë në konkurim 131 kandidatë. Konkurimi është zhvilluar në tre faza, faza e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve, faza e vlerësimit profesional me shkrim dhe faza e intervistës së strukturuar me gojë.

Në përfundim të konkurimit të kandidatëve për vendet vakante të shpallura sipas njoftimit nr. 130/155 prot., datë 01.02.2022, të Prokurorit të Përgjithshëm, Komisioni pasi ka bërë vlerësimin me pikë për secilin kandidat, ka hartuar Listën Përfundimtare të kandidatëve, të renditur nga kandidati që ka marrë më shumë pikë te ata që kanë marrë më pak.

Bazuar në renditjen përfundimtare dhe verifikimeve përkatëse të 21 kandidatëve të renditur të parët, rezulton se kandidati Remzi Duraku është shpallur fitues për një nga vendet e shpallura vakant dhe plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji. Për këto arsye, Prokurori i Përgjithshëm e ka propozuar z. Remzi Duraku për ta emëruar si oficer të policisë gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, vend për të cilin ai ka kandiduar. Duke patur parasysh sa më sipër, referuar propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm, akteve që u administruan nga Komisioni dhe akteve ligjore që rregullojnë

organizimin dhe veprimtarinë Policisë Gjyqësore, Komisioni i Policisë Gjyqësore e gjen të bazuar në ligj kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin e z. Remzi Duraku si oficer të policisë gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Rezulton se kandidati Remzi Duraku plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 17 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë gjyqësore” për tu përzgjedhur si oficer i policisë gjyqësore të seksioneve të policisë gjyqësore të prokurorisë. Përzgjedhja e tij është bërë mbi bazën e zhvillimit të një konkurimi të drejtë dhe transparent, sipas kërkesave të ligjit dhe Rregullores nr. 21/6, datë 10.06.2020 të Komisionit të Policisë Gjyqësore “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të Prokurorisë”.

Gjithashtu, kandidati ka shfaqur pëlqimin për kryerjen e trajnimit fillestar për hetimin, si një nga kushtet e kerkuara nga neni 17, gërma “ç” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë gjyqësore”.

Referuar procesit të përzgjedhjes së kandidatëve fitues, që është zhvilluar nga Prokurori i Përgjithshëm, si një proces objektiv, i studjuar dhe në respektim të akteve ligjore dhe kompetencave që ligji i njej Prokurorit të Përgjithshëm, Komisioni i Policisë Gjyqësore nuk konstaton pengesa ligjore për emërimin e oficerit të policisë gjyqësore Remzi Duraku.

Për sa më sipër, Komisioni i Policisë Gjyqësore, bazuar në nenin 10, pika 1, gërma “b” dhe nenin 11 pika 4 të Ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

V E N D O S I :

1. Emërimin e zotit **Remzi Duraku** oficer të policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Kukës**.
2. Për këtë vendim njoftohet zoti **Remzi Duraku**.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme.

K O M I S I O N I

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR
ARJAN MUÇA

ANËTAR
HARI GOGO

ANËTAR
REDI VASILI

ANËTAR
ALBERT MUÇO